

"Audituesit civilë" të APPA dhe buletini Maj 2016 si hartë risku

Nga Redi Ametllari

Auditues, KLSH

Shoqëria civile shërben si etalon për të matur mbrothësinë demokratike të një shteti. Ajo paraqitet si një indikator i performancës së një shteti demokratik, ekzistenca e së cilës nuk fillon me regjistrimin si OJQ, por me përfshirjen e saj aktive në vendimmarrjen politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit. Formula tradicionale e demokracisë është balancimi i pushteteve megjithatë ky ekuacion nuk është kaq i lehtë, porse kërkon sinergjizimin midis forcave të ndryshme, qoftë të suazës shtetërore ashtu edhe asaj civile. Në këtë këndvështrim, në baraslargimin e tre pushteteve shoqëria civile shërben si forcë balancuese, një pushtet i katërt, paralel me median e pavarur.

Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile nënkupton kritikë, alternativë dhe zgjidhje duke formuar atë që quhet një reagim qytetar për të forcuar llogaridhënien dhe përmirësuar qeverisjen e mirë në sektorin publik. Mbrojtja e interesit publik kërkon pjesëmarrjen e vetë "interesi publik". Është kjo një nga arsyt kryesore që KLSH ka nënshruar 22 marrëveshje bashkëpunimi me organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Ky partneritet midis një institucioni shtetëror dhe shoqërisë civile është një marrëdhënie sinergjike, e cila ka dëshmuar se jep rezultate konkrete në mbrojtjen e interesit publik, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit.

Një kontribut të tillë e realizon Albanian Platform for Policy Advocacy (APPA), një organizatë të rinjsh me profesione të ndryshme të cilët monitorojnë veprimtaritë dhe politikat shtetërore duke kontribuar në llogaridhënien, transparencën dhe qeverisjen e mirë në sektorin publik. Secili anëtar është përgjegjës për një ministri, kjo bazuar tek kompetencat akademike dhe profesionale duke formuar kështu një grup "audituesish civilë". Raportet e tyre, të përmbledhura në buletinë të përmuajshëm ofrojnë një skaner të asaj çka nuk shkon në veprimtarinë shtetërore, duke tërhequr kështu vëmendjen e opinionit publik e për rrjedhim nxitur llogaridhënien e institucioneve përkatëse. Buletini i muajit Maj 2016, botuar nga kjo organizatë, paraqet një hartë të risqeve që cenojnë interesin publik.

Buletini ofron një analizë makro të ekonomisë, ku thekson se borxhi publik ka tejkaluar madje fashën e "rezistencës" së ekonomisë shqiptare. Bazuar në të dhënat më të fundit zyrtare të Ministrisë së Financave, në fund të Shtatorit 2015 borxhi ishte një trilion e 63 miliardë lekë ose rreth 73.7% e Prodhimit të Brendshëm Bruto ndërsa në fund të vitit 2016, stoku i borxhit publik pritet të arrijë në afro 1.1 trilionë lekë, një rekord historik.

Më tej, në vlerësimin e indikatorëve të ekonomisë shqiptare, veçanërisht të investimeve të huaja dhe sistemit fiskal, APPA vë në dukje se klima e të bërit biznes është përkeqësuar ndjeshëm për

shkak të egërsisë dhe pabarazisë të së ashtuquajturës fushatë e formalizimit. *"Me statistika më shumë dekurajuese se sa inkurajuese, ku vetëm në vitin 2015 u regjistruan pothuajse 3 herë më shumë çështje për falimentim të kompanive krahasuar me vitin 2014, më saktësisht në 2015 çështjet për faliment të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë ishin 64 përkundrejt 22 çështjeve në 2014"*. APPA thekson se Shqipëria po bëhet gjithnjë e më pak tërheqëse për investitorët e huaj dhe largimet e këtyre të fundit janë këmbana alarmi për ekonominë shqiptare, duke nënvizuar se ekonomia shqiptare po mbahet vetëm nga dy burime: (i) Investimet publike, të cilat janë me pikatore; (ii) Investimet e huaja direkte, të cilat po zbehen ato të duhurat duke i lënë vend investitorëve më të pasigurtë.

Koncesionet dhe Partneriteti Publik Privat janë identifikuar si zona me risk të lartë nga APPA duke evokuar edhe shqetësimet e ngritura nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. *"FMN ripërsërit mesazhet për dhënien e PPP-ve vetëm pas një analize kosto-përfitime, mos lejimin e përjashtimeve tatimore dhe vazhdimin e reformave strukturore, me qëllim përmirësimin e konkurrueshmërinë së biznesit..."*, thekson buletini. Për koncesionet, APPA na sqaron me një titull tepër shterues: *"Si të kalosh nga kompani e bllokuar në kompani fituese koncesioni brenda një viti?!!"* Më 11 maj 2016 në fletoren zyrtare gjendet i botuar vendimi për miratimin e licencës së koncesionit kundrejt shoqërisë aksionare AM-OIL, një koncesion 30-vjeçar, i cili i jep të drejtën kompanisë të kryejë veprimtarinë e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimin e nënprodukteve të saj. Me një kërkim të thjeshtë në dokumentet online të QKR-së, APPA ka zbuluar se bëhet fjalë për një kompani e cila e ka nisur aktivitetin e saj në vitin 2009 dhe që merret me projektimin, ndërtimin dhe përdorimin e impianteve teknologjike (rafinerive), tubacioneve dhe depozitave për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Në analizën e politikave qeveritare, Albanian Platform for Policy Advocacy ka identifikuar probleme të mëdha me kthimin dhe kompensimin e pronave, ku vihet në dukje se: *"Edhe pse deklarohet nga ana e qeverisë se po punohet në këtë pikë, ende nuk ka asnjë përgjigje konkrete se sa është në të vërtetë vlera e kompensimit apo edhe e pronave të cilat duhen kompensuar"*.

APPA ka zbuluar disa gjetje edhe mbi reformën në arsimin e lartë, ku sipas buletinit, nuk janë miratuar ende aktet nënligjore. *"Duke nisur nga VKM për krijimin e Bordit të Administrimit, për çlirimin e doktoraturave pas një pauze 3-vjeçare, për modelin dhe Agjencinë e Financimit të arsimit të lartë, e deri te kodi i cilësisë së arsimit të lartë janë rreth 30 akte nënligjore që duhet të ishin nxjerrë sipas afateve që përcakton ligji nga Këshilli i Ministrave"*. Përpos kësaj, duket sikur procesi legjislativ i reformës po "shitet" me tender ku Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nisur prokurimin me objekt "Konsulencë në hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të arsimit të lartë", në vlerën e 2.5 milion lekëve pa TVSH". Çudia nuk mbaron këtu. *"Tenderi me afat një mujor zyrtarët e Ministrisë i kërkojnë ekspertëve përgatitjen e rreth pesëdhjetë akteve nënligjore për të cilat së pari duhet të kërkojnë ndjesë publike që nuk i realizuan dot as për një vit dhe as me paratë që paguhen nga taksapaguesit për të bërë detyrën e tyre"*, thekson APPA në buletin e muajit 2016.

Reforma territoriale është një tjetër çështje që ka kaluar në skanerin e APPA-s. Në analizën e buletinit, theksohet se nuk po zbatohet një nga prioritetet e saj, siç është ligji i ri për Informimin Publik. *“Konstituimi i organeve të reja vendore përfundoi në Korrik-Shtator 2015, ose rreth një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri “Për të Drejtën e Informimit”. Me konstituimin e organeve drejtuese në Bashki, ri-filloi edhe ecja e afateve për caktimin e koordinatorëve të të drejtës së informimit dhe adoptimin e programeve institucionale të transparencës. Nëse për institucionet e tjera afati ligjor për marrjen e masave për implementimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit skadonte në 3 maj 2015, për bashkitë e reja të krijuara, me analogji, ai skadon në datë 3 maj 2016”.*

“Pacient, nuk është më kryefjala e Sistemit Shëndetësor Shqiptar”, kështu fillon titulli i "auditimit civil" të Ministrisë së Shëndetësisë, ku vërehet një keqmenaxhim i sistemit me pasoja të rënda për buxhetin e shtetit dhe jetën e qytetarëve. APPA nxjerr në pah se *"110 milionë lekët e harxhuar për ngritjen e një qendre të konsultës ambulatorë pranë QSUT-së duhet të ishin përdorur për të ngritur qendra të konsulencës në çdo zonë të banuar me qytetarë shqiptarë”.*

Për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, APPA vë në dukje se rritja e numrit të aksidenteve, bazuar në të dhënat e INSTAT, nuk vjen vetëm nga pakujdesia e drejtuesve, por edhe nga mungesa e sigurisë së qarkullimit dhe sinjalistika rrugore. Tragjedia e ndodhur në aksin rrugor Plepa-Rrogzhinë, ku humbën jetën dy fëmijë, si pasojë e prerjes së barrierave mbrojtëse të rrugës, vjen si një tjetër dëshmi e këtij fakti. *"Trendi rritës i aksidenteve nuk po ndalet, por kjo fatkeqësisht po shoqëron edhe rritjen e pasojave në jetë njerëzore. Mund të themi lirisht se politikata e qeverisë në këtë drejtim kanë dështuar dhe për këtë nuk mjafton vetëm kërkesa për dorëheqje ndaj Ministrit Haxhinasto, por një përgjegjësi tërësore e kësaj mazhorance si një premtim i pa mbajtur”.*

Në analizën e Portit të Durrësit, APPA nënvizon se konflikti midis shoqërisë koncesionare të Terminalit Lindor dhe shoqërive të tjera të licencuara që kryejnë veprimtarinë e ngarkim shkarkimit të anijeve po dëmton rëndë TAP-in, projektin më strategjik në historinë e Shqipërisë, duke i bërë thirrje Kontrollit të Lartë të Shtetit për të adresuar këtë problematikë. *"E drejta për kryerjen e operacionit të shkarkimit të tubave të projektit TAP i është dhënë shoqërisë koncesionare EMS APO. Por ku qëndron problemi? Autoriteti Portual Durrës zotëron të gjitha kapacitetet operacionale, njerëzore dhe teknike, për ta kryer këtë operacion. Duket mjaft e dyshimtë që ky veprim nga ana e Drejtorit të APD të jetë kryer nisur nga interesi i cilësisë më të lartë, pasi siç e theksuam më lart APD zotëron të gjitha asetet e specializuara për përpunimin e mallrave të përgjithshme, ku hyjnë edhe tubat. Dyshimi bëhet edhe më i madh nëse analizon aspektin financiar të këtij operacioni, konkretisht: nëse operacioni do të kryhej në Terminalin nën administrim dhe menaxhim të saj APD do të përfitonte 55% të tarifës së shkarkimit, ndërkohë që tashmë ajo do të përfitojë vetëm 11% të tarifës. Faktet e mësipërme meritojnë vëmendjen e institucioneve përgjegjëse, veçanërisht të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Buletini bën një analizë të të gjithë ministrive, madje edhe të atyre ministrive pa portofol, të cilat në fakt janë barrë për portofolin e shqiptarëve duke përbërë në terësi një hartë risku. Forma e*

komunikimit e përzgjedhur nga APPA, me botimin e një buletini, është një gjetje mjaft konçize për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik, duke i shërbyer kështu transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke vlerësuar këtë kontribut të vyer të APPA-së, e ka përcjellë buletinin tek të gjithë punonjësit e KLSH-së që të njihen me këtë material.